



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 7 nëntor 2016
Nr. ref.:RK999/16

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI86/16

Parashtrues

“BENI”, Ndërmarrje Tregtare

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të
Kosovës, E. Rev. nr. 33/2015, të 9 dhjetorit 2015**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Gazmend Rexhepi, pronar i Ndërmarrjes Tregtare “BENI”, me seli në Prishtinë (në tekstin e mëtejshëm: kompania parashtruese), e përfaqësuar nga firma e avokatisë “JUDEX” me seli në Prishtinë.

Vendimi i kontestuar

2. Kompania parashtruese konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, E. Rev. nr. 33/2015, të 9 dhjetorit 2015 në lidhje me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, Ae. nr. 87/2014, të 13 majit 2014 dhe Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, Ae. nr. 25/2015, të 17 prillit 2015.
3. Aktgjykimi i Gjykatës Supreme i është dorëzuar kompanisë parashtruese më 5 shkurt 2016.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme, E. Rev. nr. 33/2015, të 9 dhjetorit 2015.
5. Kompania parashtruese pretendon shkeljen e nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenit 119 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në lidhje me nenin 6 [E drejta për gjykim të drejtë] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: Konventa) dhe nenin 10 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: Deklarata Universale).
6. Kompania parashtruese kërkon vënien e masës së përkohshme dhe ndalimin e ekzekutimit të vendimeve të kontestuara të Gjykatës Supreme dhe të Gjykatës së Apelit.

Baza juridike

7. Kërkesa bazohet në nenet 21.4 dhe 113.7 të Kushtetutës dhe në nenet 27, 47 dhe 48 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji), si dhe rregullat 55 dhe 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

8. Më 2 qershor 2016, kompania parashtruese dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
9. Më 17 qershor 2016, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bekim Sejdiu gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Almiro Rodrigues (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Ivan Čukalović (gjyqtarë).
10. Më 30 qershor 2016, Gjykata e njoftoi përfaqësuesin e kompanisë parashtruese për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ai që të paraqesë dëshminë që tregon datën e pranimin të vendimit të kontestuar. Të njëjtën ditë, nga një kopje e kërkesës u është dërguar Gjykatës Supreme dhe Gjykatës Themelore të Prishtinës.

11. Më 8 korrik 2016, Gjykata Themelore në Prishtinë dorëzoi dëshminë (fletë-kthesën), që tregon ditën e pranimin të vendimit të kontestuar të Gjykatës Supreme nga përfaqësuesi i kompanisë parashtruese.
12. Më 26 shtator 2016, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

13. Më 8 gusht 2012, paditësi “Jack Daniel’s Properties” paraqiti padi, duke pretenduar se kompania parashtruese kishte shkelur markën e tyre tregtare, sepse kishte importuar 100 (nëqind) paketa Uiski me shenjën “Jack Daniel’s”.
14. Më 9 dhjetor 2013, Gjykata Themelore në Prishtinë, me Aktgjykimin I. C. nr. 342/2012, e refuzoi të pabazuar padinë e paditësit “Jack Daniel’s Properties”, të paraqitur kundër kompanisë parashtruese. Gjykata Themelore arsyetoi se paditësi nuk kishte arritur të provojë se kompania parashtruese kishte shkelur markën tregtare të tij, siç përcaktohet me nenin 8 të Ligjit, për Markat Tregtare.
15. Më 26 dhjetor 2013, paditësi “Jack Daniel’s Properties” paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit kundër aktgjykimit të lartpërmendur të Gjykatës Themelore, duke pretenduar shkelje esenciale të dispozitave procedurale, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale.
16. Më 13 maj 2014, Gjykata e Apelit me Aktgjykimin, Ae. nr. 87/2014, pranoi ankesën e paditësit si të bazuar, ndryshoi aktgjykimin e ankimuar të Gjykatës Themelore dhe vërtetoi se: (i) kompania parashtruese kishte shkelur markën tregtare të paditësit kur kishte importuar 100 (nëqind) paketa Uiski me shenjën “Jack Daniel’s”, pa autorizimin e paditësit, dhe (ii) paditësit i lejohet shkatërrimi i mallrave të importuara dhe të ndaluara në doganë.
17. Gjykata e Apelit arsyetoi se kompania parashtruese kishte importuar mallin në kundërshtim me nenin 8.2, paragrafi 3 i Ligjit për Markat Tregtare, sepse me heqjen e paautorizuar të kodeve nga malli, paditësit i është pamundësuar mbrojtja e mallit të tij origjinal nga mallrat falsë që qarkullojnë në treg.
18. Më 30 qershor 2014, kompania parashtruese paraqiti kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme kundër aktgjykimit të lartpërmendur të Gjykatës së Apelit. Kompania parashtruese u ankua për shkelje esenciale të dispozitave procedurale dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale.
19. Më 16 dhjetor 2014, Gjykata Supreme me Aktvendimin, E. Rev. nr. 42/2014, e pranoi revizionin e kompanisë parashtruese si të bazuar, ndërsa aktgjykimin e ankimuar të Gjykatës së Apelit e prishi dhe lëndën e ktheu për rigjykim dhe rivendosje. Gjykata Supreme, ndër të tjera, arsyetoi se Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave procedurale, për shkak se është kundërthënë me vetveten, dhe se ekzistojnë kundërthënie ndërmjet aktgjykimit dhe përmbajtjes së shkresave të lëndës.

20. Më 17 prill 2015, Gjykata e Apelit me Aktgjykimin, Ae. nr. 25/2015, sërish vërtetoi se kompania parashtruese kishte shkelur markën tregtare të paditësit, duke importuar 100 (njëqind) paketa Uiski me shenjën “Jack Daniel’s” pa autorizim dhe duke shlyer kodet e prodhimit. Gjykata e Apelit ritheksoi, ndër të tjera, se kompania parashtruese kishte hequr kodet nga mallrat në mënyrë të paautorizuar, ashtu që paditësit i është cenuar e drejta për ta mbrojtur mallin e tij origjinal nga mallrat falsë që janë në qarkullim në treg.
21. Më 24 qershor 2015, kompania parashtruese sërish paraqiti kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme kundër aktgjykimit të lartpërmendur të Gjykatës së Apelit. Kompania parashtruese kryesisht u ankua për shkelje të dispozitave esenciale procedurale dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, shpërfillje të fakteve dhe provave vendimtare dhe autorizimin të parregullt të paditësit.
22. Më 9 dhjetor 2015, Gjykata Supreme me Aktgjykimin, E. Rev. nr. 33/2015, e refuzoi, si të pabazuar revizionin e kompanisë parashtruese të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit.
23. Për sa i përket shqyrtimit të provave dhe fakteve vendimtare, pjesa relevante e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, përcakton:

“[...] në revizion nuk është paraqitur asnjë pretendim konkret se cila provë e cila gjendet në shkresat e lëndës, nuk është shqyrtuar nga gjykata. Pretendimi i cekur në revizion se dispozitivi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë është në kundërshtim me arsyet e dhëna, sepse janë injoruar faktet vendimtare se çka është shkelja e markës tregtare, duke u mbështetur vetëm në kodin (i cili mungon në shishet e importuara nga i padituri), Gjykata Supreme e Kosovës e vlerësoi si të pabazuar, ngase, dispozitivi i aktgjykimit të kundërshtuar është në harmoni me arsyetimin e aktgjykimit dhe provat ekzistuese në lëndë”.
24. Për sa i përket zbatimit të së drejtës materiale, pjesa relevante e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, përcakton:

“Fakti se paditësi nuk ka paraqitur asnjë provë se kodet janë hequr, si janë hequr, dhe nga kush janë hequr [...], Gjykata Supreme i shqyrtoi, por të njëjtat nuk patën ndikim që të merret ndonjë vendim tjetër, ngase me rastin e shqyrtimit të çështjes nuk ka qenë kontestuese se në shishet e pijes alkoolike kontestuese ka munguar kodi, por kontestuese në mes palëve ka qenë a paraqet mungesa e kodit shkelje të markës tregtare të paraparë sipas legjislacionit të vendit tonë”.
25. Për sa i përket pretendimeve të Kompanisë parashtruese lidhur me analizat laboratorike të mallit dhe legjitimitetit të paditësit, pjesa relevante e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, përcakton:

“Gjykata Supreme e Kosovës, shqyrtoi edhe pretendimet tjera të revizionit se sipas raportit të Doganës pas analizave laboratorike, mostrat e analizuara të artikullit pije alkoolike Jack Daniel's i përgjigjet kushteve të kualitetit sipas Rregullores 16/88 dhe 63/88, se nuk vërehen ndryshime në mes shisheve, se malli i kontestuar përmban etiketat, por këto fakte kanë

të bëjnë me vërtetimin e gjendjes faktike, për të cilat në bazë të nenit 214 par. 2 të LPK, revizioni nuk mund të paraqitet.

Lidhur me pretendimin se autorizimi i paditësit nuk është valid, ngase është dokument formë dhe si i tillë ai noterizohet pranë organit publik - Noterisë, Gjykata Supreme e Kosovës, e vlerësoi si të pabazuar, ngase në shkresat e lëndës ekziston autorizimi i paditësit i cili i përmbushë kriteret sipas Kreut V - përfaqësuesit me prokurë, të Ligjit të Procedurës Kontestimore”.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

26. Kompania parashtruese pretendon shkeljen e nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenit 119 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës dhe nenin 10 të Deklaratës Universale.

27. Kompania parashtruese pretendon se:

“Me vendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës E. Rev. nr. 33/2015 si dhe me vendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës Ae. nr. 25/2015 në asnjë rast nuk është vërtetuar e drejta e "Jack Daniel 's Properties" për të kërkuar mbrojtjen e markës tregtare, nuk është vërtetuar nëse parashtruesi i kërkesës ka bërë shkeljen e markës tregtare dhe ku konsistojnë këto shkelje. Gjithashtu Gjykata Supreme e Kosovës ka pranuar si të drejtë një vendim i cili nuk bazohet në dispozitat ligjore të cilat janë mjaft të qarta, por vendos sipas mendimit të saj”.

28. Kompania parashtruese i propozon Gjykatës që: “(i) të lejoj masën e përkohshme, (ii) të lejoj masën e përkohshme derisa Gjykata Kushtetuese të vendosë lidhur me kërkesën për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, E. Rev. nr. 33/2015, të 9 dhjetorit 2015, dhe Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ae. nr. 25/2015, të 17 prillit 2015, dhe (iii) të pezullojë menjëherë procedurën e ekzekutimit të Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, E. nr. 33/2015, të 9 dhjetorit 2015 dhe Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ae. nr. 25/2015, të 17 prillit 2015”.

29. Për sa i përket kërkesës për vënien e masave të përkohshme, Kompania parashtruese shton se me vendimin e Gjykatës Supreme pijet e importuara me vlerë prej 12,840,00 euro janë në procedurë të shkatërrimit dhe se kompania parashtruese do të pësonte dëm të pariparueshëm nëse nuk caktohen masat e përkohshme.

Pranueshmëria e kërkesës

30. Gjykata së pari do të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

31. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, që përcakton:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

32. Gjykata po ashtu i referohet nenit 48 të Ligjit, që parasheh:

*Neni 48
Saktësimi i kërkesës*

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

33. Gjykata, më tej, merr parasysh rregullin 36 (2) d) të Rregullores së punës, që specifikon:

*Rregulli 36
Kriteret e pranueshmërisë*

“(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

*...
d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.*

34. Në rastin konkret, Gjykata vëren se kompania parashtruese në përgjithësi nuk pajtohet me rezultatin e rastit në procedurën e zhvilluar në gjykatat e rregullta.
35. Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e faktit ose të ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta gjatë vlerësimit të provave apo zbatimit të ligjit (ligjshmëria), përveç dhe për atë sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura nga Kushtetuta (kushtetutshmëria).
36. Gjykata Kushtetuese rikujton se nuk është gjykatë e gjetjes së fakteve, dhe se vërtetimi i drejtë dhe i plotë i gjendjes faktike është juridiksion i plotë i gjykatave të rregullta. Roli i Gjykatës Kushtetuese është vetëm që të sigurojë respektimin e standardeve kushtetuese gjatë proceseve gjyqësore në gjykatat e rregullta, prandaj, nuk mund të veprojë si “gjykatë e shkallës së katërt” (Shih, rastin *Akdivar kundër Turqisë*, Nr. 21893/93, GJEDNJ, Aktgjykimi i 16 shtatorit 1996, para. 65, po ashtu *mutatis mutandis* shih rastin KI86/11, parashtrues i kërkesës *Milaim Berisha*, Aktvendim për papranueshmëri, i 5 prillit 2012).
37. Gjykata vëren se kompanisë parashtruese i është mundësuar zhvillimi i procedurës bazuar në parimin e kontradiktoritetit; se ajo kishte mundësi që, gjatë fazave të ndryshme të procedurës, të nxjerrë argumente dhe dëshmi që ajo i konsideroi relevante për rastin e saj; se asaj i është dhënë mundësia që të kontestoj në mënyrë efektive argumentet dhe dëshmitë e paraqitura nga pala

kundërshtare; dhe se të gjitha argumentet që ishin relevante për zgjidhjen e rastit të saj janë dëgjuar e shqyrtuar nga gjykatat e rregullta; se arsyet faktike e ligjore ndaj vendimit të goditur ishin shtruar hollësisht. Rrjedhimisht, rezulton se procedurat në gjykatat e rregullta, shikuar në tërësinë e tyre, ishin të drejta (Shih, për shembull, rastin *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, [DHM], aplikacioni nr. 30544/96, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 29).

38. Për më tepër, Gjykata konsideron se kompania parashtruese vetëm citon dispozitat e Kushtetutës, pa dëshmuar se si ato norma kushtetuese janë shkelur në dëm të tyre, siç kërkohet me nenin 48 të Ligjit.
39. Si përfundim, Gjykata konsideron se kompania parashtruese nuk i ka dëshmuar pretendimet për shkelje të të drejtave themelore të njeriut të garantuara me Kushtetutë.

Kërkesa për masë të përkohshme

40. Kompania parashtruese ka kërkuar vënien e masave të përkohshme për shkak se: *“shkatërrimi i këtyre produkteve do të shkaktonte dëm të pariparueshëm për parashtruesin e kërkesës”*.
41. Gjykata i referohet nenit 27 të Ligjit, që parasheh:

*Neni 27
Masat e përkohshme*

“Gjykata Kushtetuese sipas detyrës zyrtare ose me kërkesë të palës mund të vendos përkohësisht masa të përkohshme ndaj një çështjeje që është objekt i procedurës, nëse këto masa janë të nevojshme për të evituar rreziqe ose dëme të pariparueshme, ose nëse marrja e këtyre masave të përkohshme është në interes publik”.

42. Gjykata po ashtu i referohet rregullit 55 (4) të Rregullores, që specifikon:

“[...] Para se Kolegji shqyrtues të mund të rekomandojë pranimin e kërkesës për masë të përkohshme, ai duhet të konstatojë që:

(a) pala që kërkon masën e përkohshme ka treguar rastin prima facie për meritat e kërkesës dhe, nëse akoma nuk është vendosur për pranueshmërinë e saj, rastin prima facie për pranueshmërinë e kërkesës;

43. Siç u përmend më lart, kompania parashtruese nuk ka treguar rastin *prima facie* për pranueshmërinë e kërkesës. Rrjedhimisht, kërkesa për masë të përkohshme duhet të refuzohet si e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenet 27 dhe 48 të Ligjit dhe me rregullat 36 (2) (d) dhe 55 (4) të Rregullores së punës, më 26 shtator 2016, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues


Bekim Sejdiu



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Arta Rama-Hajrizi